

## Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2023

**Tiranë, më 26 Prill 2024:** Në këtë publikim, statistikat e krimeve japin informacion mbi veprat penale, autorë të veprave penale, persona të dëmtuar, procedime penale, persona të pandehur dhe të dhëna mbi të burgosurit.

### Vepra penale

Në vitin 2023, janë evidentuar gjithsej 33.845 vepra penale, 1,1 % më shumë, krahasuar me vitin 2022.


**Tab. 1 Vepra penale të evidentuara**

Vepra penale	2019	2020	2021	2022	2023
Vrasje me dashje	58	52	61	42	34
Vrasje të mbetura në tentativë	93	114	101	93	94
Krime me dashje kundër shëndetit	2.449	2.521	2.176	1.823	1.987
Krime seksuale	155	146	136	169	134
Vjedhje (neni 134)	4.290	3.909	3.508	2.661	2.712
Vjedhje me dhunë	85	88	85	65	80
Vjedhje me armë	13	14	11	13	9
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	76	46	67	97	41
Mashtrome	959	876	975	1.062	1.003
Fallsifikim monedhash	84	86	67	51	26
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.341	1.505	1.631	1.887	1.911
Krime në fushën e drogës	1.989	2.086	3.078	2.887	3.046
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.652	5.300	5.854	5.682	5.551
Tjetër	17.966	15.993	17.425	16.944	17.217
<b>Gjithsej</b>	<b>35.210</b>	<b>32.736</b>	<b>35.175</b>	<b>33.476</b>	<b>33.845</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Veprat penale Krime me dashje kundër shëndetit, Krime në fushën e drogës, Vjedhje, Dhuna në familje (neni 130/a) janë rritur, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesa tjetër e veprave penale ka pësuar rënie.

**Fig. 1 Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2023-2022**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

### Autorë të veprave penale

Në vitin 2023, janë regjistruar 39.489 autorë për vepër penale, 3,4 % më shumë, krahasuar me vitin 2022. Numri i autorëve sipas veprave penale përfshin numrin e personave të dyshuar të cilët mund të jenë të pranishëm në më shumë se një vepër penale dhe autori numërohet në të gjitha veprat ku është i dyshuar. Ndërkohë, numri i autorëve pa përsëritje në veprat penale, në vitin 2023 është 33.470 autorë, 3,2 % më shumë, krahasuar me vitin 2022.


**Tab. 2 Autorë për vepër penale**

Vepra penale	2019	2020	2021	2022	2023
Vrasje me dashje	78	70	67	36	41
Vrasje të mbetura në tentativë	113	139	150	115	119
Krime me dashje kundër shëndetit	3.279	3.342	2.964	2.433	2.739
Krime seksuale	162	165	142	178	143
Vjedhje( neni 134)	2.608	3.019	2.685	1.995	2.528
Vjedhje me dhunë	101	94	113	99	107
Vjedhje me armë	34	35	17	19	10
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	104	54	89	122	51
Mashtrime	983	954	1088	1281	1068
Fallsifikim monedhash	69	69	98	54	22
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.438	1.604	1.733	2.003	2.029
Krime në fushën e drogës	2.703	3.202	3.793	3.609	3.954
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.473	5.128	5.672	5.538	5.579
Tjetër	25.900	23.081	20.717	20.716	21.099
<b>Autorë Gjithsej</b>	<b>43.045</b>	<b>40.956</b>	<b>39.328</b>	<b>38.198</b>	<b>39.489</b>
<b>Autorë pa përsëritje të veprave penale</b>	<b>36.083</b>	<b>35.213</b>	<b>35.745</b>	<b>32.420</b>	<b>33.470</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Meshkujt përbëjnë 93,2 % të totalit të autorëve të veprave penale.


**Fig. 2 Autorë gjithsej dhe autorë meshkuj për vepër penale**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Në vitin 2023, 35,8 % e autorëve janë të grup-moshës 30-44 vjeç, 26,5 % të grup-moshës 18-29 vjeç dhe 21,2 % i përkasin grup-moshës 45-59 vjeç.

**Fig. 3 Autorë për vepër penale sipas grup-moshës, 2023**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

### Të dëmtuar

Në vitin 2023, janë regjistruar 17.021 persona të dëmtuar, 24,7 % më shumë, krahasuar me vitin 2022. Personat e dëmtuar për krime kundër personit përbëjnë 38,4 % të totalit të personave të dëmtuar.


**Tab. 3 Të dëmtuar**

Të dëmtuar	2019	2020	2021	2022	2023
Krime kundër jetës	1.416	1.466	1.303	970	1.241
Krime kundër shëndetit	2.986	3.072	2.616	1.846	2.296
Krime seksuale	148	132	129	143	125
Vepra penale kundër lirisë së personit	181	143	120	144	166
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	321	305	313	268	392
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1.652	1.772	1.881	2.119	2.278
Të tjera kundër personit	40	38	49	32	45
<b>Të dëmtuar për krime kundër personit</b>	<b>6.744</b>	<b>6.928</b>	<b>6.411</b>	<b>5.522</b>	<b>6.543</b>
<b>Të dëmtuar gjithsej</b>	<b>18.858</b>	<b>17.829</b>	<b>16.910</b>	<b>13.650</b>	<b>17.021</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Në vitin 2023, 36,6 % e personave të dëmtuar për krime kundër personit ishin femra dhe përqindja më e madhe e tyre vihet re në Krime seksuale, Krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes si edhe Krime kundër moralit dhe dinjitetit.

**Fig. 4 Të dëmtuar për krime kundër personit sipas gjinisë, 2023**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

### Procedime penale


Në vitin 2023, numri i procedimeve penale të regjistruara është 24.095 procedime, 6,3 % më pak, krahasuar me vitin 2022. Nga 23.419 procedime penale të përfunduara, 26,5 % e tyre janë pushuar, 31,0 % janë pezulluar dhe 42,5 % janë dërguar për gjykim në gjykatë.

**Tab. 4 Procedime penale të regjistruara**

Veprat penale	2019	2020	2021	2022	2023
Vrasje me dashje	137	128	117	93	62
Vrasje të mbetura në tentativë	28	35	48	35	42
Krime me dashje kundër shëndetit	903	861	823	667	677
Krime seksuale	158	136	158	162	124
Vjedhje (neni 134)	8.682	7.812	7.010	6.093	5.191
Vjedhja me dhunë	117	123	112	84	84
Vjedhja me armë	15	15	11	16	10
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	85	68	78	79	82
Mashtrime	745	627	752	696	687
Fallsifikim monedhash	82	75	62	42	23
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.140	1.251	1.406	1.453	1.410
Krime në fushën e drogës	1.548	1.793	2.069	1.585	1.804
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	4.038	3.911	4.374	4.385	4.236
Tjetër	13.017	11.017	11.329	10.318	9.663
<b>Gjithsej</b>	<b>30.695</b>	<b>27.852</b>	<b>28.349</b>	<b>25.708</b>	<b>24.095</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

**Fig. 5 Progresi i procedimeve penale të përfunduara**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

### Të pandehur

Në vitin 2023, janë regjistruar 13.963 persona të pandehur, 14,1 % më pak, krahasuar me vitin 2022. Të pandehurit për veprat penale Vrasje të mbetura në tentativë dhe Mashtrime janë rritur, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesa tjetër ka pësuar rënie.


**Tab. 5 Të pandehur**

Veprat penale	2019	2020	2021	2022	2023
Vrasje me dashje	132	110	87	108	80
Vrasje të mbetura në tentativë	32	28	59	37	58
Krime me dashje kundër shëndetit	542	508	614	527	461
Krime seksuale	111	101	128	131	78
Vjedhje (neni 134)	1.078	979	1.102	1.041	983
Vjedhja me dhunë	70	73	85	57	56
Vjedhja me armë	18	14	9	13	9
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	86	42	68	62	52
Mashtrime	384	328	328	270	296
Falsifikim monedhash	38	22	34	27	13
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.038	1.081	1.304	1.419	1.172
Krime në fushën e drogës	921	1033	1487	1626	1259
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.152	3.213	3.689	3.955	3.437
Tjetër	7.119	5.877	7.202	6.973	6.009
<b>Gjithsej</b>	<b>14.721</b>	<b>13.409</b>	<b>16.196</b>	<b>16.246</b>	<b>13.963</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Meshkujt përbëjnë 94,7 % në totalin e personave të pandehur.

**Fig. 6 Persona të pandehur sipas gjinisë**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

### Të burgosur

Në vitin 2023, numri i të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale është 5.169, 4,6 % më shumë, krahasuar me vitin 2022. Meshkujt përbëjnë 98,5 % të totalit të të burgosurve.


**Tab. 6 Të burgosur sipas veprave penale**

Vepra penale	2019	2020	2021	2022	2023
Vjedhje	811	713	684	733	752
Vrasje	1.006	1.012	895	944	954
Plagosje	74	80	95	96	100
Krime seksuale	117	112	45	44	41
Krime në fushën e drogës	1.580	1.311	1.431	1.377	1.539
Organizata kriminale	78	71	70	79	72
Mashtrim	129	121	127	117	129
Shfrytëzim prostitucioni	67	51	44	41	46
Të tjera	1.183	1.143	1.565	1.513	1.536
<b>Gjithsej</b>	<b>5.045</b>	<b>4.614</b>	<b>4.956</b>	<b>4.944</b>	<b>5.169</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Grup-mosha 21-29 vjeç ka numrin më të lartë të të burgosurve. Personat mbi 60 vjeç dhe nën 20 vjeç kanë numrin më të ulët të të burgosurve.

**Fig. 7 Të burgosur sipas grup-moshës**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

# Metodologjia

*Burimi i të dhënave:* Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet evidencës vjetore të detajuar sipas neneve të Kodit Penal, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të dhënat mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.

## 1. Vepra penale

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

## 2. Autorë

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

## 3. Persona të dëmtuar

Të dëmtuarit/viktimat e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti.

## 4. Procedime penale

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara, pushuara, pezulluara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim.

Procedime të regjistruara janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin korrent. Procedime të pushuara janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Procedime të pezulluara janë vendimmarrjet e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një vepre penale.



## 5. Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një veprë penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar. Për qëllime statistikore, në totalin e të pandehurve janë shtuar të dhëna edhe për personat nën hetim.

## 6. Të burgosur

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në dhjetor të çdo viti. Të dënuar me burg i referohet personave që ndodhen në burgje, të cilët kanë marrë dënimin përfundimtar me burgim. Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

### Përkufizime

**Vrasje me dashje:** Vepër e kundraligjshme, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përshihen veprat penale si: Neni 76 Vrasje me dashje, Neni 77 Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 Vrasje me paramendim, Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje, Neni 79 Vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a Vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, Neni 81 Vrasje e foshnjës.

**Krime seksuale:** Përfshihen nenet 100-108/a të Kodit Penal.

**Vjedhje me dhunë:** Përfshihet neni 139 i Kodit Penal.

**Krime me dashje kundër shëndetit:** Përfshihen nenet 86-90 të Kodit Penal.

**Mashtrime:** Përfshihen nenet 143-149/b të Kodit Penal.

**Fallsifikim monedhash:** Përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

**Krime në fushën e drogës:** Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

**Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor:** Përfshihen veprat penale si: Neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi, Neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.